



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:248624
Datë: 27.03.2025
Numri i dokumentit: 07055571

Ac.nr.6744/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka, kryetare e kolegjit, Nora Bllaca-Dula dhe Naim Meholli, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I.K nga fshati V., Komuna e Glllogocit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Hasan Haxhaj, avokat nga Glllogoci, kundër të paditurës Komuna e Glllogocit Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Flamur Curri, për kompensimin e pagës, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Dega në Glllogoc, C.nr.****/21 të datës 16.09.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.03.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit I.K nga fshati V., Komuna e Glllogocit, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Glllogoc, C.nr.****/21 të datës 16.09.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.****/21 të datës 16.09.2022, në pikën I (një) të dispozitivit e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit I.K nga fshati V., Komuna e Glllogocit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Glllogocit – Drejtoria për Arsim që ti kompensoj paditësit shumën prej 479,32 euro, në emër të pagës së pa paguar për periudhën kohore 19.08.2021 deri me 18.09.2021, me kamatë ligjore 8% në vit duke filluar nga dt.05.11.2021 kur është parashtruar padia në gjykatë e deri në pagesën definitive si

dhe shpenzimet e procedurës. Në pikën II (dy) të dispozitivit ka vendosur që secila palë t'i bart shpenzimet e veta procedurale .

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka paraqitur ankesë paditësi nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit që ankesa të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i atakuar të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Nga shkresat lëndës nuk rezulton se e paditura të ketë ushtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të LPK-së, ka gjetur se:

Ankesa e paditësit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi I.K nga fshati V., Komuna e Glllogocit, me datë 05.11.2021, në gjykatën e shkallës së parë ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Glllogocit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që ta detyrojë të paditurën që paditësit në emër të pagës së pa paguar për periudhën kohore 19.08.2021 deri me 18.09.2021 t'ia paguaj shumën prej 479,32 euro, me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës, me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të prezantuara nga palët ndërgjyqëse, në seancën e shqyrtimit kryesor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.****/21 të datës 16.09.2022, me të cilin e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga provat e administruara ka gjetur se kërkesa e padisë së paditësit për realizimin e pagës së pa paguar për periudhën kohore 19 gusht deri me datë 18 Shtator 2021 është e pa bazuar, ngase paditësi nuk i ka pasur 6 muaj të punës së pa ndërprerë në vitin kalendarik 2021 kur ka filluar punën tek e paditura në bazë të kontratës së punës me dt. 18.05.2021, pushimi vjetor për punëtorët e arsimit në bazë të nenit 33 paragrafi 1 të LP-së shfrytëzohet në kohën e pushimeve verore, paditësi nuk ka prezantuar provë për të argumentuar se ka pasur të krijuar marrëdhënie pune para datës 18.05.2021 dhe se i njëjti gjatë shqyrtimit gjyqësor ka pohuar se deri me datën 18.08.2021 i është paguar paga edhe përkundër faktit se në bazë të kalendarit për vitin shkollor 2020-2021 të MASH viti shkollor 2021 ka përfunduar me datën 17.06.2021 për klasat 9,10 dhe 11 përkatësisht në shkollat ku ka punuar paditësi sipas kontratës së punës, andaj meqë të njëjtit i është paguar paga për këtë periudhë kohore e paditura zyrtarisht në bazë të nenit 35 paragrafi 1 dhe neni 36 paragrafi 1 të LP-se e ka minusuar përkatësisht i ka ndaluar paditësit pjesën e pagës për të cilën i ka paguar në emër të pushimit vjetor edhe përkundër faktit se nuk i ka takuar. Nga tërë kjo ka ardhur në përfundim se e paditura nuk ka asnjë obligim ligjor në raport me paditësin, andaj kërkesëpadinë e paditësit e ka refuzuar si të pabazuar.

Përkitazi me pretendimet e paditësit se e paditura nuk ka pas të drejtë ta minusoj pagën e muajit shtator me arsyetimin se është paguar për periudhën prej datës 1 deri me dt. 18 gusht të vitit 2021 dhe se pretendimi se paditësi kërkon realizimin e pagës siç realizojnë të gjithë mësimdhënësit tjerë të cilët janë në zëvendësim pa kurrfarë ndërprerje paguhen në muajin korrik dhe gusht pavarësisht zhvillimit të procesit mësimor dhe se interpretimi i dispozitës ligjore nga e paditura se të punësuarve në 6 muajt e parë nuk ju takon e drejta e kompensimit të pushimit vjetor nuk vlen për punëtorët e arsimit sepse të njëjtit edhe pas përfundimit të vitit shkollor janë të obliguar të dalin në punë deri më datë 15 korrik në këtë rast viti 2021, gjykata ka arsyetuar se të njëjtat i ka refuzuar për faktin se ishin në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar me administrim të provave, ngase paditësi gjykatës nuk i ka prezantuar provë për të argumentuar se paditësi ka pasur të krijuar marrëdhënie pune edhe para datës 18.05.2021 kur ka filluar punën tek e paditura sipas kontratës për të argumentuar faktin pretendues se ka mbi 6 muaj përvojë pune në vitin kalendarik 2021.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje të dispozitave procedurale, ngase një pretendim i tillë është paraqitur në mënyrë të gjeneralizuar dhe të paqartë pa specifikuar dispozitën eventuale të shkelur apo ndonjë rrethanë e cila do e arsyetonte pretendimin e tillë ankimor, pra se cilat dispozita janë shkelur dhe ku konsiston shkelja e pretenduar. Në anën tjetër kolegjit të Gjykatës së Apelit me shikim në shkresat e lëndës gjegjësisht procesverbaleve të seancave gjyqësore i rezulton se procesi gjyqësor për trajtimin e çështjes konkrete juridike është zhvilluar në mënyrë të rregullt konform dispozitave ligjore të LPK-së.

Perëndime ankimore për gjendjen faktike nuk janë paraqitur, ndërsa e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë. Me dispozitën e nenit 33 paragrafi 1 të Ligjit të Punës nr.03/L-212 shprehimisht është përcaktuar se: “Pushimi vjetor i arsimtarëve të të gjitha niveleve, edukatorëve dhe personelit tjetër arsimor dhe administrativ nëpër shkolla dhe në institucionet e tjera edukativo-arsimore, shfrytëzohet në kohën e pushimeve verore të shkollave dhe mund të zgjasë deri sa të zgjasë pushimi nëpër institucionet edukativo-arsimore”. Dispozita e nenit 35 paragrafi 1 të këtij ligji parasheh se: “I punësuar i cili për herë të parë themelon marrëdhënie pune ose i cili nuk ka ndërprerje më tepër se pesë (5) ditë pune, fiton të drejtën për shfrytëzimin e pushimit vjetor pas gjashtë (6) muajsh të punës së pandërprerë, në proporcion me muajt e punuar”, ndërsa me dispozitën e nenit 36 paragrafi 1, pika 1.1 të të njëjtit ligj është përcaktuar se: “I punësuar ka të drejtë, së paku një ditë e gjysmë (1.5) të pushimit, për çdo muaj kalendarik të kaluar në punë, nëse: 1.1. në vitin kalendarik në të cilin për herë të parë ka themeluar marrëdhënie pune, nuk i ka gjashtë (6) muaj të punës së pandërprerë”.

Nga interpretimi i dispozitave të sipërcituara ligjore dhe gjendja e vërtetuar faktike rezulton se gjykata e shkallës së parë drejt ka aplikuar të drejtën materiale e cila për qëndrimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara, bindëse faktike dhe juridike për faktet vendimtare për vendosje në këtë çështje juridike dhe se drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, kjo për faktin se në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se paditësi me të paditurën me dt. 18.05.2021, ka lidhur kontratë pune dhe se me këtë datë paditësi kishte filluar punës sipas kontratës për pozitën *arsimtar lëndor*, kohëzgjatja e të cilës ishte *derisa të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë*, poashtu nuk ishte kontestuese se për vitin shkollor 2020-2021 - viti shkollor 2021 ka përfunduar me datën 17.06.2021 për klasat 9,10 dhe 11 përkatësisht në shkollat ku ka punuar paditësit, ndërsa edhe përkundër faktit se viti shkollor 2021 ka përfunduar me datën 17.06.2021 pra zyrtarisht paditësi ishte në pushim vjetor të njëjtit i ishte paguar paga deri me dt. 18.08.2021 (pra edhe për muajin gusht të këtij viti) . Andaj fakti se paditësit i është paguar paga mujore për muajin gusht të vitit 2021 që zyrtarisht për punëtorët e arsimit ka qenë muaj i pushimit vjetor dhe se sipas dispozitave të sipërcituar ligjore paditësi nuk kishte të drejtën e kompensimit të pushimit vjetor, pasi që i njëjti nuk kishte 6 muaj përvojë pune në vitin kalendarik 2021 tek e paditura, dhe meqë në rastin konkret ishte kompensuar gabimisht nga e paditura, kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka gjetur se llogaritja e pagesës për pagën për të cilën i ka paguar në emër të pushimit vjetor edhe përkundër faktit se nuk i ka takuar, si kompensim për muajin shtator kur edhe zyrtarisht fillon viti i ri kalendarik gjegjësisht për periudhën kohore nga data 01.09.2021 deri me dt.18.09.2021 gjegjësisht duke zbritur pagën e këtij muaji në emër të pagës së paguar pa bazë gjatë kohës së pushimit vjetor është e drejtë mbi të cilën bazë edhe kërkesëpadia e paditësit është refuzuar si e pa bazuar nga gjykata e shkallës së parë, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Nga të cekurat më lart, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për pabazueshmërinë e kërkesëpadiës së paditësit është i drejtë dhe i argumentuar. Mbi këtë gjendje faktike të vërtetuar, gjykata ankimore e pranon në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë edhe për zbatimin e drejtë të dispozitave materialo - juridike në të cilat është thirrur me rastin e vendosjes, nga edhe ka rrjedhur pathemelësia e kërkesëpadiës së paditësit, pasi që zbatimi i këtyre dispozitave në përputhje me konstatimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, argumenton plotësisht qëndrimin e kësaj të fundit se kërkesëpadia e paditësit në rastin konkret është e pabazuar. Për këtë arsye gjykata e shkallës së dytë gjen se ankesa e paditësit në rastin konkret është e pabazuar.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi të gjitha pretendimet ankimore të palës paditëse, mirëpo i vlerësoi si të pabazuara për faktin se këto pretendime janë paraqitur nga pala paditëse edhe në seancat e mbajtura gjyqësore për të cilat gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të detajuara në aktgjykimin e ankimuar e me të cilat qëndrime dhe vlerësime të dhëna nga gjykata e shkallës së parë, kjo gjykatë pajtohet në tërësi dhe janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë.

Pretendimin ankimor të paditësit duke ju referuar diskriminimit të punëtorëve që marrëdhënien e punës e themelojnë me kontratë në kohë të caktuar në raport me ata të cilët kanë kontrata në kohë të pacaktuar, kolegji i kësaj gjykate e vlerësoi si jo relevant për vendosje ndryshe në këtë çështje juridike dhe në këtë fazë të procedurës ngase kërkesa e padisë nuk i referohet kohëzgjatjes së kontratës së punës e aq më pak kur vet paditësi me vullnetin e tij të lirë (fakt i pa kontestuar)

Numri i lëndës: 2021:248624
Datë: 27.03.2025
Numri i dokumentit: 07055571

e kishte lidhur kontratën e punës kohëzgjatja e të cilës ishte *derisa të kthehet punëtorja nga pushimi i lehonisë*, andaj pretendimi për diskriminim me arsye të dhëna nga paditësi si në ankesë në këtë çështje i pabazuar dhe jo relevant.

Nga arsyet e paraqitura më lart e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.6744/22, me datë 24.03.2025

Kryetarja e kolegjit
Halide Reka d.v